



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:014697

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05749463

KPPP.nr.88/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Inspektorati Shëndetësor, me seli në Prishtinë, rruga “Instituti B”, kati përdhësë, rrethi i QKUK-së, kundër debitorit “Olive Medical Group” SH.P.K., me seli në Mitrovicë, rruga “Minatorët e Trepçës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.483/23 të datës 14.12.2023, të Përmbartuesit Privat Fazli Gjonbalaj, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Olive Medical Group” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.483/23 të datës 14.12.2023, të Përmbartuesit Privat Fazli Gjonbalaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.483/23 i datës 14.12.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fazli Gjonbalaj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.483/23 të datës 14.12.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor - Vendimit të Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/AJ-125-22 të datës 05.12.2022, me të cilin ka urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri t’i paguaj kreditorit shumën prej 6,000.00 € me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore sipas Tarifës së Përmbartuesve Privat nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, në të kundërtën përmbartimi të realizohet me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në

të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e tyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, duke theksuar se kjo lëndë është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit andaj procedura përmbarimore duhet të pezullohet deri në vendosjen nga Gjykata e Apelit. Tutje ka shtuar se në vendimin e atakuar inspektorja ka ndëshkuar personin fizik në cilësinë e themeluesit të IPSH “Olive Medical Group”, me gjobë në shumë prej 6,000.00 €, me pretendimin se i njëjti ka shkelur dispozitat ligjore për shëndetësi, andaj si i tillë ky vendim nuk është i ligjshëm i njëjti është nxjerr me shkelje të shumta. I ka propozuar gjykatës që ta pranoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta anuloj në tërësi.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht – Vendimin e Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/AJ-125-22 të datës 05.12.2022, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Vendimi i Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/AJ-125-22 i datës 05.12.2022, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit:

“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi i Inspektoratit Shëndetësor Nr.10/AJ-125-22 i datës 05.12.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmëris për përbarueshmëri”, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: “Vërtetimin për përbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”, ngase Vendimi Nr.10/AJ-125-22 i datës 05.12.2022, i nxjerrë nga Inspektorati Shëndetësor, është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 14.11.2023.*

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka parashtruar padi për hapjen e konfliktit administrativ, e njëjta lëndë është duke u trajtuar pranë Gjykatës së Apelit dhe se janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës përbarimore dhe pritjen e zgjidhjes së çështjes paraprake, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore, ngase në nenin 22 të Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”. Andaj fakti se debitori ka parashtruar padi nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përbarimore.*

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.88/24, datë 29.05.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.